



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosova



Komuna e Istogut  
Opštine Istok /Municipality of Istok

---

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi / Direkcija za Poljoprivredu, Šumarstvo i Hidro  
privredu / Department of Agriculture , Forestry and Hydro-economy

09. Nr. 260/2022

Datë; 09.11.2022

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë, bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.  
Br.01- 815/022 të datës 26.11.2022 shpallë:

**THIRRJE PËR APLIKIM**  
**Mbështetje për koston e certifikimit organik**

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Istogut që të aplikojnë për subvencionim të koston e certifikimit me standardin organik bi-OS EU ekuivalent me standardin EEC 834/2007.

Mënyra e përkrahjes së fermave dhe përpunuesve të certifikuar me standardin organik EEC 834/2007.

- Planifikohet mbështetja financiare në shumën 70 % të vlerës së faturës së paguar për procesin e certifikimit, por jo më shumë se 900 €.
- Në raste të tejkalimit të shumës së planifikuar , komisioni përzgjedhës, mund të ulë shkallen e përkrahjes.
- Do të kompensohen personat fizik dhe juridik që janë në sistem/ skemë certifikimi, në kalim (viti i parë, viti i dytë, viti i tretë) ose në certifikim.
- Nuk mbështetet inspektimi i jashtëzakonshme nga trupa certifikuese.

**Kriteret e përgjithshme që duhet ti plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Operatoret ekonomik dhe fermerët duhet të jenë banor të Komunës së Istogut dhe të zhvillojnë aktivitetin afarist në territorin e Komunës së Istogut.
- Te jenë në skemë certifikimi apo të certifikuar me standardin organik EEC 834/2007.

**Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Letërnjoftimi
- Certifikata e biznesit për personat juridik
- Vërtetim i tatimit në pronë, për personat fizik
- Vërtetim i shlyerjes së obligimeve ose kontrata e marrëveshjes me ATK-në, për personat juridik, vërtetimi mund të sillej edhe mbas mbylljes së thirrjes por para ekzekutimit të pagesës.
- Dëshmi të certifikimit, certifikata dhe vendimi i certifikimit lëshuar nga trupa certifikuese

- Fatura përfundimtare tatimore e lëshuar nga trupat e akredituar certifikuese
- Dëshmi të pagesës së plotë të faturës
- Deklaratë nen betim për mos financim të dyfishtë të të njëjtit aktivitet
- Deklaratë nen betim për të dhënat e sakta të prezantuara me rastin e aplikimit (merret në Drejtorin e Bujqësisë, zyra Nr. 200).

Vërejte:

Nëse komisioni parasheh te nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë te cilat mundësojnë zgjidhjen e përfituesit (fermerit) është i obliguar qe ti sjell ato ne afatin i cili i caktohet ne te kundërtën humb te drejtën për të qenë përfitues i subvencionit.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi fillon që nga dita e shpalljes publike, nga data 10.11.2022 dhe përfundon më datë 18.11.2022 ne ora 16.00.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetar Nr. 100.

Aplikacionet që nuk e kanë dokumentacionin e kërkuar sipas thirrjes nuk do të shqyrtohen.

Informacione shtesë mund të merren në Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë në zyrën Nr. 200.

Drejtori:

Astrit Hajrizaj

